

Metodologji e punës shkencore

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, Programi: <i>Gjermanishtja si gjuhë e huaj</i>
Titulli i lëndës:	Metodologji e punës shkencore
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti V, semestri X
Numri i orëve në javë:	2
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.asoc.dr. Sadije Rexhepi
Të dhënat kontaktuese:	sadije.rexhepi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Në këtë lëndë studentët do të mësojnë dhe ushtrojnë të shkruarit e teksteve funksionale që iu nevojiten studentëve gjatë studimit, si projektpropozim, seminare si dhe të punuarit e punimit final, pra punimit të masterit.</p> <p>Këtu do të mësohet për metodat e punimeve shkencore, për metodat e grumbullimit të materialit hulumtues, përpunimin e materialit të hulumtuar, hartimin e fusnotave, të civateve sipas normës ndërkombëtare, hartimin e përmbajtjes, bibliografisë, regjistrin të emrave dhe të shprehjeve etj., të cilat do t'i shërbenin studentit për hartimin e punimeve me shkrim gjatë studimeve si dhe në fund për hartimin e punimit të masterit.</p> <p>Me rëndësi këtu është të mësohen hapat e hulumtimit dhe mënyra e analizës praktike e korpusit për të nxjerrë rezultate të mira të hulumtimit për një temë të caktuar. Këtu studentët duhet të ambientohen me vlerësimin kritik të raporteve të publikuara të hulumtimeve kuantitative dhe kualitative në fushën e mësimdhënies.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimet e kësaj lënde janë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të njoftohen studentët me mënyrat e përpilimit të një ekspozije (projekt-propozimi),- të njoftohen studentët me fazat e hulumtimit,- të njoftohen me mënyrat e hulumtimit të literaturës,- të informohen studentët me teknikat e nevojshme për hartimin e një punimi shkencor,

- të njoftohen studentët me metodologjinë hulumtuese kuantitative - dhe kualitative,
- të njoftohen studentët me metodologjinë kontrastive dhe krahasimtare.
- të njoftohen studentët me prezantimin e nje punimi shkencor.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

- Pas përfundimit të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje:
- të dinë të përpilojnë ekspozë,
 - të njohin metodat hulumtuese të aplikueshme në fushën e tyre të studimit,
 - të vlerësojnë në mënyrë kritike raportet e publikuara në fushën e tyre të studimit,
 - të planifikojnë hulumtimin e tyre,
 - të aplikojnë metodologjinë hulumtuese kuantitative dhe kualitative në hulumtimin e tyre,
 - të aplikojnë metodologjinë hulumtuese kontrastive dhe krahasimtare në hulumtimin e tyre.
 - të prezantojnë hulumtimin e tyre.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	7	3	21
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	5	2	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	45 min	2	1.5
Total			92.5 orë (92.5:25 = 3.7)

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike, konsultimeve dhe ushtrimeve që realizohen me punë në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi. Po ashtu punohen edhe projekte, seminar, të cilat referohen dhe rreth të cilave diskutohet në orë.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit dhe detyrat individuale të kryera në shtëpi 10% Exposé 20% Punimi i seminarit 50% Prezantimi në klasë 20%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Eco, Umberto. 2020. <i>Wie man eine wissenschaftliche Abschlussarbeit schreibt</i>. Heidelberg. 2. Pospiech, Ulrike. 2017. <i>Wie schreibt man wissenschaftliche Arbeiten?</i> Duden-Ratgeber. Berlin. 3. Hahn, Sophie. 2021. <i>Wissenschaftliches Arbeiten: So wird Ihre Bachelor- oder Masterarbeit und jede andere Wissenschaftliche Arbeit zu einem Meisterwerk</i>. PLK Verlag. 4. Gruber / Huemer / Rheindorf. 2009. <i>Wissenschaftliches Schreiben. Ein Praxisbuch für Studierende</i>. Weimar. 5. Kornmeier, Martin. 2008. <i>Wissenschaftlich Schreiben leicht gemacht - für Bachelor, Master und Dissertation</i>, Bern. 6. Grätz, Frank. 2006. Duden. <i>Wie verfasst man wissenschaftliche Arbeiten?: Ein Leitfaden für das Studium und die Promotion</i>. Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich. 7. Balzert/Schröder/ Schäfer. 2012. <i>Wissenschaftliches Arbeiten</i>, Wilhelm Büchner Hochschule, Darmstadt. 8. Rothstein, Björn. 2011. <i>Wissenschaftliches Arbeiten für Linguisten</i>, Narr Verlag, Tübingen. 9. Esselborn- Krumbiegel, Helga. 2010. <i>Richtig wissenschaftlich schreiben. Wissenschaftssprache in Regeln und Übungen</i>, UTB, Stuttgart. 10. Bunting, Karl-Dieter; Bitterlich, Axel; Postpiech, Ulrike. 2000. <i>Schreiben im Studium mit Erfolg</i>, Ein Leitfaden, Berlin. <p>Esselborn- Krumbiegel, Helga. 2010. <i>Richtig wissenschaftlich schreiben. Wissenschaftssprache in Regeln und Übungen</i>, UTB, Stuttgart.</p>
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Karmasin, Mathias, Ribing, Rainer. 2010. <i>Die Gestaltung wissenschaftlicher Arbeiten: Ein Leitfaden für Seminararbeiten</i>, Stuttgart. 2. Trapp, Sebastian. 2007. <i>Wie man tatsächlich eine wissenschaftliche Arbeit schreibt: Daten, Schreibtechnik, Zeitplanung, Veröffentlichung - in der realen Welt</i>. 3. Pospiech, Ulrike. 2005. <i>Duden Ratgeber - Wie schreibt man wissenschaftliche Arbeiten? Alles Wichtige von der Planung bis zum fertigen Text</i>. Mannheim.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Prezantimi i silabusit
Java 2:	Procesi i të shkruarit – parashkrimi dhe planifikimi
Java 3:	Etapat e hulumtimit për një punim shkencor
Java 4:	Procesi i të shkruarit-shkrimi dhe redaktimi i projektideve
Java 5:	Të shkruarit e një exposéje
Java 6:	Metodologjia hulumtuese kuantitative dhe kualitative
Java 7:	Metodologjia kontrastive dhe krahasimtare
Java 8:	Gjuha dhe stili i punimit shkencor
Java 9:	Prezantimi i exposesë
Java 10:	Argumentimi; Rrjedha kronologjike dhe logjike, rrjedha e shkakut dhe e pasojës si dhe e krahasimit dhe kontrastimit
Java 11:	Analiza praktike e të dhënave
Java 12:	Citimet, dokumentimi i burimeve
Java 13:	Redaktimi
Java 14:	Prezantimi i punimeve seminarike
Java 15:	Prezantimi i punimeve seminarike

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët marrin pjesë aktive në ligjëratë, për t'i thelluar njohuritë nga kjo fushë. Ata e zhvillojnë veten me aktivitete jashtë mësimore, si: biblioteka, detyra dhe seminare.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën në heshtje për të punuar rreth aktiviteteve në klasë; aktivitete të tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara. Telefonat mobil/të mençur duhet të fiken (apo të jenë pa zë) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimt. Nga të gjithë pritet të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve gjatë diskutimeve dhe të mos përdorët gjuhë e pahijshme.

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme.